

# STREHIMI I MIRËFILLTË I QENVE



Ndërtimi i strehimoreve tradicionale për strehim të përhershëm të qenve endacak, nuk është një masë themelore e një programi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të popullsisë së qenve. Mbajtja e qenve në strehimore kushton jashtëzakonisht shumë, prandaj mirëqenia e qenve të mbajtur në ambiente të tilla mund të jetë shumë e ulët.

Në situatën e tanishme me qentë endacak në Kosovë, **ndërtimi i strehimoreve** si masë urgjente për zvogëlimin e numrit të qenve endacak, **do të kishte kosto tejet të lartë**, dhe nuk do të kishte aspak efekt për zvogëlimin e numrit të qenve në rrugë, pasi që strehimoret mbushen shpejt deri në kapacitetet e tyre të plota, ndërsa qentë zëvendësohen në rrugë përmes shumimeve të vazhdueshme dhe braktisjes.

Strehimoret pa mbështetje financiare, pa sistematizim të punës, pa zbatim të masave të tjera për menaxhimin e popullsisë së qenve, dhe pa gatishmërinë e qytetarëve për të adoptuar qen, do të mbipopullohen shpejt dhe do të nxisin pronarët t'i braktisin qentë e tyre afër strehimoreve dhe në rrugë.

Strehimoret adresojnë vetëm "simptomat e problemit", do të thotë të popullsisë aktuale të qenve endacak dhe jo burimin e këtyre qenve. Fatkeqësisht, supozimi i gabuar se strehimoret mund të ndihmojnë në "pastrimin e rrugeve" nga qentë është i zakonshëm dhe mund të jetë veçanërisht térheqës për politikanët.

**Prandaj, strehimoret nuk duhet të konsiderohen si prioritet kryesor në vendet si Kosova, ku ka numër të madh të qenve në rrugë dhe adoptime minimale.**

Strehimoret private dhe publike, pa punë transparente dhe pa llogaridhënie, shpesh mund të bëhen qendra fitimprurëse që keqpërdorin donacionet dhe fondet publike dhe që kanë prioritet përfitimet financiare të individëve e jo mirëqenien e qenve që strehojnë apo reduktimin e numrit të qenve në rrugë.



Megjitatë, themelimi i qendrave të shpëtimit ose qendrave të përkohshme të strehimit, me kapacitete të vogla dhe me programe të ristrehimit dhe adoptimit, që sigurojnë strehim të përkohshëm për qentë deri në adoptimin e tyre, mund të luajë një rol të rëndësishëm në zbatimin e suksesshëm të programeve për menaxhimin dhe kontrollin e popullsisë së qenve.

Krijimi i këtyre qendrave mund të jetë ndihmesë e madhe që qentë e rrugës të adoptohen nëpër familje.

## **KRITERET DHE STANDARDET PËR NJË QENDËR TË MIRËFILLTË TË STREHIMIT**

### **1. TRANSPARENCA**

Qendra e strehimit duhet të jetë e hapur për publikun dhe të informojë vazhdimesh mbi punën dhe kushtet e qendrës.


### **2. STAFI I KUALIFIKUAR**

Stafi i qendrës duhet të ketë ekspertizën e nevojshme për të gjitha proceset e trajtimit të qenve duke filluar nga kapja, transporti, mjekimi, trajnimi, ushqimi, socializimi, promovimi i qenve për adoptim dhe këshillimi i personave të interesuar për adoptim.

### **3. HAPËSIRA ADEKUATE**

Të gjitha dhomat e qendrës, e posaçërisht vendet ku qëndrojnë qentë, duhet të kenë lartësi, gjerësi dhe thellësi të mjaftueshme, të përshtatshme për lloje të ndryshme të qenve.

Qendra duhet të ketë hapësirë për karantinë, hapësirë për lojë, ushtrime, socializim, dhe hapësirë për mbajtje individuale të qenve të cilët nuk përshtaten me qen të tjera.



**4.**

## KUJDESI VETERINAR

Qendra e strehimit duhet të punojë ngushtë me një klinikë veterinare, pasi që kujdesi i vazhdueshëm mjekësor për qentë është thelbësor.

**5.**

## EUTANAZIA

Një qendër e mirë strehimi do të ndjekë një politikë "jo vrasëse" dhe do të përdorë eutanazinë vetëm në rrethanat ku kafshët kanë sëmundje të pashërueshme ose përjetojnë vuajtje ekstreme.

**6.**

## PROGRAMET E TRAJNIMIT

Qenve u mësohen komanda bazike nga staf i trajnuar kurse kafshët me probleme të sjelljes duhet të risocializohen nga ekspertët e sjelljes së kafshëve.

**7.**

## PROMOVIMI I ADOPTIMEVE

Një qendër e mirëfilltë e strehimit në thelb të punës së saj e ka ristrehimin apo adoptimin e kafshëve. Përmes programeve të promovimit të adoptimit, minimizohet koha e kaluar në strehimore për qentë, duke ulur kështu gjasat për rrezikim të mirëqenies së kafshëve për shkak të qëndrimit të gjatë në strehimore.

Qendra duhet të nënshkruajë kontratë për çdo kafshë të adoptuar dhe të bëjë kontrolla dhe vizita vijuese pas adoptimit për t'u siguruar që kafsha e adoptuar është duke jetuar një jetë të mirë.



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fondacija za prava životinja

WWW.ANIMALRIGHTS-RKS.ORG  
INFO@ANIMALRIGHTS-RKS.ORG